




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK



Zyra e Kryetarit  
Nr. 01/43/21  
Datë: 09.07.2021

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.09.2010, Kryetari i Komunës me datë: 09.07.2021, merr këtë:

### VENDIM



- I. Themelimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut të shoqëruar me breshër.
- II. Komisioni përbëhet nga tre anëtarë:
  1. Ali Gacaferi -- Zyrtar për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Ambjent,
  2. Avdyl Maloku -- Zyrtar për Zhvillim Ekonomik,
  3. Florant Pepshi -- Shef i Sektorit për Buxhet dhe Financa.
- III. Komisioni do të hartoj raport të detajuar për vlerësimin e dëmeve në teren për kulturat bujqësore në Komunën e Junikut.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Anëtarët e Komisionit
2. Arkiva komunale

Kryetari i Komunës  
z. Agron Kuci





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit  
Nr. 01/44/21  
Datë: 04.08.2021

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.09.2010, neni 3 paragrafi 3.4, nën paragrafi 3.4.8, neni 12, i Rregullores për Simbolet, Titujt e Nderit, Dekoratat, Medaljet, Mirënjohjet dhe Falënderimet në Komunën e Junikut Kryetari i Komunës me datë: 04.08.2021, merr këtë:

### VENDIM

- I. Për ndarjen e Mirënjohjes nga Komuna e Junikut për Z.Zenel Krasniqi.
- II. Kjo Mirënjohje ndahet për kontributin jetësor në veprimtarinë kulturore, artistike, patriotike e atdhetare në Kosovë, mërgatën shqiptare në Kroaci e diasporë dhe aktivitetin e vazhdueshëm në përpjekje të kombit tonë për Çlirim dhe Liri.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari.

Me këtë vendim njoftohen:

1. I permenduri më lartë,
2. Arkiva komunale

Kryetari i Komunës  
z. Agron Kuçi

